



**DRAFT- REVIZIONI URBANISTIK
PËR KOMUNËN DIBËR - 2022**

Përmbajtja

1.	Mjedisi rajonal	3
1.1	Ekonomia rajonale dhe kufijtë e rrethinës së komunës . 5Error! Bookmark not defined.	
1.2	Demografia	9
2.	2.Pozicionimi urbanistik dhe organizimi i komunës Dibër	11
2.1	Përfshirja e tokës.....	12
3.	3.Trendet dhe projeksionet e popullatës.....	13
4.	4.Ekonomia	15
4.1	Infrastruktura rrugore lokale dhe banimi	20
4.2	Bujqësia	21
4.3	Turizmi dhe hotelieria	23
5.	5.Shërbime, mjete dhe mirëmbajtje	24
5.1	Fondet e komunës.....	33
5.2	Punët për mirëmbajtje	34
6.	6.Mangësitë dhe nevojat.....	35
7.	7.Projektet e zhvillimit urban, të përfunduara, në vazhdim dhe projekte në të ardhmen	36
8.	8.Projektet e propozuara, përzgjedhja dhe konsultime	40
8.1	Pasqyrë e procesit të konsultimit.....	40
8.2	Kriteret për kualifikimin dhe prioritizimin e projekteve	46

1. Mjedisi rajonal

Komuna Dibër gjindet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i takon Rajonit planor Jug- perëndimor. Komuna gjindet në Fushën e Dibrës ndërmjet vargmaleve Deshat, Liqenit të Dibrës dhe ultësirës së Lumit Drini i Zi, e cila njëkohësisht e mbush liqenin sëbashku me Lumin Radika. Teritori i Komunës Dibër në veri- lindje kufizohet me komunën Mavrovë dhe Rostushë, në jug me Qendrën Zhupë dhe në një pjesë të vogël me Strugën, në jug- lindje me Kërçovën dhe Debërcën dhe në perëndim me Republikën e Shqipërisë.



Fotografia 1: Komuna Dibër



Fotografia 2: Vendbanimet e Komunës

Komuna Dibër është komunë e vjetër dhe si e tillë ka funksionuar në periudha të ndryshme. Nga viti 2004 në pajtueshmëri me Ligjin për organizim territorial dhe vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM- së nr. 22/2004) komuna Dibër është formuar në kufijtë në të cilat egzisto edhe tani. Komuna numëron gjithsej 18 vendbanime, nga të cilat sipas Rregjistrimit të popullsisë të vitit 2002, 3 fshatra janë tërësisht të zbrazura (Bomova, Konjara, Taraniku). Kryeqendra e komunës është qyteti i Dibrës.

Sipas rregjistrimit të popullsisë të vitit 2021 në komunë jetojnë 15.412 banorë në territor prej 145.75 km² ku dendësia e popullsisë është 105,74 banorë/km². Numri i përgjithshëm i familjeve në vitin 2021 shënon 4.157 me numër mesatar të anëtarëve të familjes prej 3,71. Sipas llogaritjeve të Entit shtetëror për statistikë nga viti 2021, popullsia e përgjithshme e Komunës shënon 15.412 banëro, nga të cilët 7.677 (49,81%) janë meshkuj ndërsa 7.735 (50,19%) femra.

Komuna Dibër paraqet mjedis multi-etnik dhe multikulturor. Struktura nacionale e popullsisë është si në vijim: 8.438 (54,75%) Shqiptarë; 2.733 (17,23%) Turq; 1.155 (7,49%) Maqedonë; 1.140 (7,40%) Romë; 424 (2,75%) Të tjerë të papërmendur; 8 (0,05%) Boshnjakë; 6 (0,04%) Të panjohur; 5 (0,03%) Serbë; 2 (0,01%) Vllehë; 2 (0,01%) Nuk janë deklaruar.

Komuna ka pozitë mjaft të favorshme gjeografike. Në sipërfaqen e saj ballafaqohen dy lugina kanjonesh të rrëndësishme dhe piktoreske në rrjedhën e lumenjve Radika dhe Drini i Zi. Bukuritë natyrore të maleve: Deshat, Korab dhe Stogovë, me të cilat është e rrethuar komuna, liqeni i Dibrës, Banjat e Dibrës dhe

zbulime të rrëndësishme arkeologjike, biodiversiteti dhe atraksionet kulturore, mundësojnë vizitë të frekuentushme të komunës përgjatë gjithë vitit.

Liqeni akumulues Shpile bije në grupin e hidrocentraleve më produktive në Maqedoninë e Veriut me rreth 300 milion kv/orë në vit.

Komuna Dibër është karakteristike për bollëkun e ujërave gjeotermal, të përfaqësuara nëpërmjet burimeve Banisht (në lartësi mbidetare prej 900 m dhe tre burime me temperaturë prej 36°C deri në 39,3°C dhe kursim prej 5,2 deri më 51 l/sek) dhe Kosovrasti (në lartësi mbidetare prej 600m me temperaturë prej 48 °C dhe kursim prej 120 l/sek).

Në teritorin e Komunës Dibër ndodhet i vetmi relief gipsor në Maqedoni, i cili shtrihet në gjatësi prej 9 km. Gipsi është i cilësisë jashtëzakonisht të lartë: përmban 99% gips të pastër dhe për nga cilësia rangohet ndër më të mirat në botë.

Struktura e tokës përbëhet nga pyjet prej 9.064 ha (30%), kullota 10.679 ha (36%), tokë e punueshme 9.507 ha (33%) dhe tokë e papunuar 2.6ha (1%). Nga aspekti i buqësisë, në vitin 2015 kanë qenë të mbjelluara 1.742ha nga të cilat 32,15% drithëra (kryesisht gruri), 0,57% bimë industriale, 6,14% kulture kopshtarie dhe 56,83% bimë foragjere (kryesisht jonxhë). Sipas të dhënave nga Regjistrimi i tokës buqësore, viti 2007, numri i përgjithshëm i lopëve arrin në 1400 krerë, ndërsa i deleve deri në 20000 krerë. Ndër të tjera po zhvillohet bletaria si dhe prodhimi i mjaltit cilësor dhe ekologjik. Në të kaluarën, bujqësia ishte një degë e rrëndësishme ekonomike në këtë zonë, por për shkak të mundësive të kufizuara, ajo nuk mund të jetë bartëse e zhvillimit të komunës.

Numri total i popullsisë ekonomkisht active është 5.825 ose 42.55% nga popullsia totale të moshës nga 15 vjeç e lart. Numri i popullsisë ekonomkisht aktive, e cila është e punësuar është 2,417 banorë ose 17,65% e popullsisë së përgjithshme mbi 15 vjeç. Përqindja e personave ekonomkisht aktivë dhe të punësuar është jashtëzakonisht e vogël, gjë që bën që kushtet socio-ekonomike në komunë të jenë në nivel të ulët.

Popullsia urbane në komunë merret me tregti, prodhim dhe shërbime, kurse popullsia rurale me blegtori, bujqësi dhe pylltari.

Bartësit kryesorë të ekonomisë në komunën e Dibrës janë: SHA "Knauf-Radika" (fabrika për prodhimin e gipsit dhe produkteve të parafabrikuara të gipsit); SHA "Deplast" (fabrika për prodhimin e produkteve të ndryshme plastike); CHE "Spilje" (hidrocentrali), "Isen Komerc" (fabrika e makaronave), "Eurogypsum" (gips), "Redimix-Korab" (bazë betoni) dhe objekte të tjera më të vogla prodhuese.

Në fushën e turizmit në nivel komunal është i zhvilluar turizmi i llixhave, i cili menaxhohet nga qendra shëndetësore "Banjat e Dibrës-CAPA", me mbi 150 të punësuar dhe kapacitet akomodues prej 700 shtretërisht në hotelet e fsh. Banjisht, fsh. Kosovrast dhe në hotelin Venec në Dibër. Krahas turizmit me llixha mund të zhvillohet edhe turizmi liqenor, malor dhe rural.

Konfigurimi i terrenit në komunë mundëson kushte për shfrytëzimin e ujërave të lumenjve dhe paraqet një potencial të madh për ndërtimin e minicentraleve për prodhimin e energjisë elektrike.

Afërsia me aeroportin e Ohrit dhe rrjeti i zhvilluar rrugor i mundësojnë komunës lidhje të mira komunikacioni. Lidhja e komunikacionit të Dibrës me pjesën tjetër të Maqedonisë realizohet përmes rrugëve rajonale R-409 (Anet e Mavrovës - Dibër - kufiri me Republikën e Shqipërisë, Bllatë) dhe R-418 (Strugë-Dibër) dhe egziston rruga R- 415 (Ura e Boshkut- Burimi) i cili nuk është kompletuar plotësisht. Dy drejtimet e rrugëve rajonale R-409 dhe R-418, të cilat ndahen nga drejtimi rrugës magjistrale M-4 përgjatë dy korridoreve natyrore, gjegjësisht luginave të lumenjve të Zdrinit të Zi dhe Radikës, mundësojnë lidhjen

dhe komunikimin e lehtë të qytetit të Dibrës si dhe me vendbanimet dhe komunat fqinje si dhe me pjesën tjetër të brendshme të Republikës. Gjatësia e rrugëve rajonale nëpër komunë është 44,95 km.

Rrugët lokale që lidhin qytetin me vendbanimet janë të asfaltuara dhe rikonstruara dhe gjatësia e tyre totale është 104.99 km (të asfaltuara 39.49 km (37.61%), të shtruara me pllaka bekhatone 20.5 km (19.53%), makadam 37 km (35.24%) tokë 6 km (5,71%) dhe jo mesatarisht 2 km (1,9%).

Procesi edukativo-arsimor në komunë zhvillohet përmes tri shkollave fillore: SHF, "Said Najdeni", SHF. "Penestia" ("Vllazërim Bashkim") - Dibër me paralele në fshatin Xhepish të dhe SHF. "Riste Risteski", fsh. Kosovrasti i poshtëm me paralele në fsh. Kosovrasti i epërm dhe Mogorçë me numër të përgjithshëm prej rreth 2500 nxënës dhe një shkollë e mesme "29 nëntori" ("Zdravko Çoçkovski") me rreth 780 nxënës.

Në komunë ka 11 objekte sportive me sipërfaqe prej 17.92 m², nga të cilat tre qendra sportive, një pishinë, katër objekte në kuadër të shkollave fillore/shkollës së mesme, një sallë e qytetit dhe një stadium i qytetit si dhe një objekt i pavarur sportiv.

Sa i përket qasjes së ujit të pijshëm në komunën e Dibrës, 80% e popullsisë e plotëson këtë nevojë, kryesisht ajo urbane. Në zonat rurale zakonisht mungon sistemi për furnizim me ujë, ndaj banorët plotësojnë nevojën për ujë të pijshëm duke përdorur burimet. Edhe pse numri më i madh i banorëve në komunë janë të kyçur me ujësjellësin, është e rëndësishme të theksohet se ujësjellësit janë në gjendje mjaft të keqe (kryesisht sepse datojnë shumë kohë më parë, por edhe për faktin se ato mirëmbahen dobët). Si mungesa e madhe e një sistemi të përshtatshëm vaditjeje, i cili do të ishte i rëndësishëm nga pikëpamja e nxitjes dhe arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor.

1.1 Ekonomia rajonale dhe kufijtë e rethinës së Komunës

Sipas të dhënave paraprake të Entit Shtetëror të Statistikave, të marra nga llogaritë vjetore të subjekteve afariste dhe nga burime të tjera, bruto-produkti vendor për vitin 2018 arrin në 658.053 milionë denarë, ndërsa në krahasim me vitin 2017 nominalisht është rritur për 6,5%. Shkalla reale e rritjes së PBB-së në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, është 2.7%.

Kontributin më të madh të vlerës së shtuar me 19.6% në strukturën e PBB-së, në vitin 2018 e kanë sektorët: E, ZH dhe Z – Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Objektet e akomodimit dhe vepimatrixitë e shërbimit të ushqimit.

Konsumi final në vitin 2018, në raport me vitin 2017, nominalisht rritet me 5.3%, dhe në strukturën e PBB-së merr pjesë me 80.7%.

Kontributi i eksportit të mallit dhe të shërbimit në strukturën e PBB-së në vitin 2018 ishte 60.6%.

Vlera e investimeve në mjetet bazë në vitin 2018 është 130,242 milionë denarë.

Në strukturën teknike të investimeve në mjetet bazë, punimet e ndërtimit marrin pjesë me 57,4%, makineritë dhe pajisjet me 34,1%, dhe investimet e tjera me 8,5%.

Tabela nr. 1: Prodhimi i brendshëm bruto, viti 2003-2018

	PBB me çmime aktuale (në miliona denarë)	PBB për banor në euro (me kursin actual të këmbimit)	PBB në milionë euro (me kursin actual të këmbimit)	Shkalla e ritjes reale të PBB-së në %	PBB-deflator
2003	268 694	2 164	4 386	2.2	101.7
2004	280 786	2 252	4 578	4.7	99.8
2005	308 447	2 470	5 032	4.7	104.9
2006	334 840	2 682	5 472	5.1	103.3
2007	372 889	2 982	6 095	6.5	104.6
2008	414 890	3 308	6 772	5.5	105.5
2009	414 622	3 300	6 767	-0.4	100.3
2010	437 296	3 459	7 109	3.4	102.0
2011	464 186	3 665	7 544	2.3	103.7
2012	466 703	3 680	7 585	-0.5	101.0
2013	501 891	3 948	8 150	2.9	104.5
2014	527 631	4 141	8 562	3.6	101.4
2015	558 954	4 382	9 072	3.9	102.0
2016	594 795	4 659	9 657	2.8	103.5
2017	618 106	4 839	10 038	1.1	102.8
2018 ¹⁾	658 053	5 153	10 698	2.7	103.6

¹⁾ Të dhënat e mëparshme

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Tabela 2: Pasqyrë e subjekteve afariste aktive në teritorin e rajonit Jug-perëndimor i cili përfshin 9 komuna, sipas viteve, është në tabelën e mëposhtme:

	2018	2019	2020	2021
	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt
Rajoni Jug-perëndimor	7209	7520	7268	7218
Vevçan	103	99	103	102
Dibër	500	507	517	519
Debarcë	110	131	118	120
Kërçovë	1447	1495	1462	1411
Makedonski Brod	158	166	152	146
Ohër	2622	2774	2654	2608
Pllasnicë	52	47	46	41
Strugë	2134	2223	2138	2198
Qendra Zhupë	83	78	78	73

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Sipas treguesve së tabelës së mësipërme, numri më i madh i ndërmarrjeve në rajonin jugperëndimor janë të përqendruara në 3 komuna më të mëdha, Ohër, Strugë dhe Kërçovë. Numri i përgjithshëm i subjekteve afariste aktive në rajonin jugperëndimor për vitin 2021 është 7218, që paraqet 9,9% të numrit të përgjithshëm të subjekteve afariste në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tabela 3: Subjekte afariste aktive sipas sektoreve të veprimtarive sipas KNV-së Rev.2, në territorin e komunës Dibër, sipas viteve, gjendja më 31 Dhjetor:

	2018	2019	2020	2021
Gjithsejt	500	507	517	519
A Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	10	10	11
B Minerale dhe nxjerje e gurrëve	-	-	1	1
B Industri përpunuese	50	54	50	50
Г Furnizim me energji elektrike, gas, avull dhe klimatizim	-	-	-	-
Д Furnizimi me ujë; mënjanim i ujërave të mbetjeve; menaxhim me mbetjet; riparim i rrethinës	1	1	1	1
Ѓ Ndërtimtari	43	44	54	59
E Tregëtim me të madhe dhe të vogël; ndreqje e makinave motorike dhe motoçikletave	202	201	202	195
Ж Transport dhe magacim	24	24	26	26
З Objekte për akomodim dhe veprimtari shërbyese me ushqim	61	56	57	56
S Informacione dhe komunikim	3	3	3	2
I Veprimtari financiare dhe veprimtari me sigurime	4	4	4	4
J Veprimtari në lidhje me pronën e patundshme	-	-	1	1
K Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	22	24	27	29
Л Veprimtari administrative dhe shërbyese ndihmëtare	9	10	9	8
Љ Drejtori publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm	3	3	3	3
M Arsim	5	5	6	6
H Veprimtari të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	35	36	35	34
Ѓ Art, zbavitje dhe rekreim	11	11	10	11
O Veprimtari të tjera shërbyese	16	21	18	22

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Numri më i madh i subjekteve afariste aktive në territorin e komunës së Dibrës janë në sektorin e Tregtisë me shumicë dhe riparimit me pakicë të automjeteve dhe motoçikletave, me një diferencë të theksuar në krahasim me sektorët e tjerë. Sektori i dytë për nga numri i subjekteve afariste është ndërtimi I cili numëron 59 subjekte, i treti është veprimtaria e akomodimit dhe

shërbimit ushqimor me 56 subjekte dhe industria përpunuese me 50 subjekte. Numri i subjekteve afariste në sektorët e tjerë është më i vogël dhe varion nga 1-35 subjekte.

1.2 Demografia

Tabela 4: Sipas regjistrimit të vitit 2002, numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën e Dibrës është 19542 banorë të cilët jetojnë në 3917 familje dhe 4606 banime

Komuna	Gjithsejt banorë	Familje	Banime (të gjitha llojet e shtëpive)
Dibër	19542	3917	4606

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Tabela 4.1 Sipas regjistrimit të vitit 2021, numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën Dibër është 15412 banorë të cilët jetojnë në 4157 familje dhe 6130 banime.

Komuna	Gjithsej banorë	Familje	Banime (të gjitha llojet e shtëpive)
Dibër	15412	4157	6130

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Sipas të dhënave në Tabelën 4 dhe 4.1 vërehet që në komunën Dibër ka rrënie të numrit të banorëve për 4130 banorë.

Rrënia e numrit të banorëve të rregjistruar duke krahasuar numrin e të dyja regjistrimeve, ka të bëjë me faktin që komuna Dibër vazhdimisht ballafaqohet me paraqitjen e shpërnguljes dhe migrimit të banorëve, ndërsa numër i madh i banorëve largohen për punë të përkohshme në vendet perëndimore evropiane. E njëjta paraqitje e uljes së popullsisë referohet edhe në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke marrë parasysh që në pajtueshmëri me të dhënat nga regjistri i votuesve në zgjedhjet lokale të vitit 2021, numri i qytetarëve me të drejtë vote në Komunën Dibër gjegjësisht me moshë nga 18 vjeç e më shumë, është 19211 (burim: Komisioni shtetëror i zgjedhjeve- Zgjedhjet lokale 2021), mund të arihet në përfundim që numri real i banorëve është i ndryshëm nga të dhënat statistikore.

Tabela 5: Popullsia në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 31.12.2020 sipas grupeve specifike të moshës, sipas gjinisë, sipas komunës, sipas viteve, sipas ndryshimeve të ndarjes territoriale të vitit 2014.

Dibër	2017			2018			2019			2020		
	Gjithsejt 20939	Meshkuj 10760	Femra 10179	Gjithsejt 21003	Meshkuj 10798	Femra 10205	Gjithsejt 21044	Meshkuj 10822	Femra 10222	Gjithsejt 21075	Meshkuj 10822	Femra 10253
1-2	428	211	217	422	215	207	418	219	199	390	199	191
3-4	509	268	241	500	246	254	428	211	217	422	215	207
5-6	490	247	243	483	254	229	508	267	241	500	246	254
7-9	718	367	351	727	374	353	752	380	372	723	376	347
10-14	1285	668	617	1216	629	587	1170	603	567	1221	621	600
15-19	1481	807	674	1462	795	667	1429	774	655	1344	718	626
20-24	1829	987	842	1752	954	798	1682	916	766	1584	859	725
25-27	1171	601	570	1168	584	584	1137	578	559	1163	626	537
28-29	797	395	402	770	410	360	807	422	385	770	385	385
30-34	1861	969	892	1942	976	966	1929	978	951	1941	994	947
35-39	1667	900	767	1702	919	783	1741	937	804	1808	962	846
40-44	1497	768	729	1501	787	714	1543	809	734	1543	816	727
45-49	1373	677	696	1410	695	715	1394	689	705	1454	732	722
50-54	1419	711	708	1428	716	712	1426	727	699	1398	684	714
55-59	1265	659	606	1291	669	622	1326	677	649	1333	680	653
60-64	1075	577	498	1076	567	509	1109	581	528	1162	603	559
65-69	729	356	373	795	403	392	850	447	403	870	466	404
70-74	413	191	222	450	214	236	526	241	285	571	277	294
75-79	387	166	221	374	160	214	330	140	190	335	139	196
80+	319	122	197	328	123	205	341	133	208	348	133	215
e panjohur	6	0	6	6	0	6	6	0	6	6	0	6

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Sipas të dhënave nga tabela 5, shihet se proekcionet e numrit të popullsisë në komunën e Dibrës është në rritje të lehtë konstante. Diferenca në numrin e popullsisë ndërmjet viteve 2002 dhe 2020 është +1533 persona, domethënë popullsia është rritur me 7,84%. Ndërsa, sipas regjistrimit të vitit 2021, popullsia është 15,412.

Në analizë të mëtejshme për nevojat e Revizionit urban është kryer hulumtim në terren në vendbanimet, përkatësisht bashkësitë lokale me më shumë se 10 banorë sipas regjistrimit të vitit 2002. Ky hulumtim tregon se të dhënat nga bashkësitë lokale për nga numri i banorëve përputhen më shumë me të dhënat e Entit së statistikave nga tabela nr. 6.

Nga hulumtimi në terren u konstatua se fshatrat Selokiç-Shullan, Spas, Osoj, Kriftcë, Tatar Elevc janë të shkretë(braktisura), në fshatin Hame në mënyrë drastike numri i banorëve ku momentalisht jetojnë 2, në mënyrë drastike ka rënë numri i banorëve në fshatrat Hame, ku aktualisht jetojnë 2 amvisëri, ndërsa në fshatin Popullsia e Garit ishte 2 banorë

Në 4 vitet e fundit për të cilat ka të dhëna, gjegjësisht për vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020, në komunën e Dibrës kanë lindur mesatarisht 201.5 fëmijë në vit. Numri i lindjeve të fëmijëve në këto 4 vite është në një rënie të lehtë në krahasim me 2016 dhe 2017, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6: Lindjet e fëmijëve sipas moshave të nënave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas komunave, viteve dhe martesave të kryera në vit

Dibër	2017	2018	2019	2020
Gjithsejt	222	200	195	189
Ndër 15 vjet	0	0	0	0
15-19	13	13	9	10
20-24	70	51	48	48
25-29	76	80	82	80
30-34	40	40	39	32
35-39	20	12	12	19
40-44	3	4	5	0
45-49	0	0	0	0
më shumë se 50 vjet dhe e panjohur	0	0	0	0

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

2. Pozicionimi urban dhe organizimi i Komunës Dibër

Komuna e Dibrës shtrihet në një sipërfaqe prej 145,75 km² dhe shtrihet në rajonin jugperëndimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që përbën 4,27% të sipërfaqes së përgjithshme të rajonit jugperëndimor, i cili shtrihet në një territor prej 3,340 km². Selia e Komunës është qyteti i Dibrës dhe ka edhe 17 fshatra të tjera, përkatësisht: Banjisht, Bomovë, Gari, Kosovrasti i epërm, Dibër, Kosovrasti i poshtëm, Konjara, Krivca, Mogorçë, Osoj, Otishan, Rajçicë, Selokiç – Shullan, Spas, Tatar Elevci, Taranik, Hame. Sipas të dhënave statistikore të regjistrimit të vitit 2002, fshatrat Bomovë, Konjari dhe Taranik janë tërësisht të shkreta, kurse nga hulumtimet në terren (korrik 2022) nuk ka banorë në fshatrat Selokiç-Shulan, Spas, Krivcë, Osoj dhe Tatar Elevci. Fshatrat Gari dhe Hame kanë më pak se 10 banorë.

2.1 Përfshirja e tokës

Tabela nr. 7 Përfshirja e tokës

Vendbanime	1. Banim					2. Destinime tjera					Σ
	1.1	1.2	1.3	1.4	Σ	2.1	2.2	2.3	2.4	Σ	
	Sipërfaqe - Banim me shërbime	Sipërfaqe - Banim me shërbime jo i mjaftueshëm	Sipërfaqe - Banim i parregullt	Sipërfaqja e tokës së pa urbanizuar (ara, kullota, livadhe, pyje dhe të tjera)	Sipërfaqja e përgjithshme - Banim	Objektet e mëdhaja	Veprimtari	Sipërfaqet e gjelbërta	Rrugët - hapësirë e hapur	Sipërfaqja e përgjithshme - destinime të tjera	
ha	ha	ha	ha	ha	ha	ha	ha	ha	ha	ha	
Banjsht	6.72	1.48		966.98	8.2	0	0.52	3	0.3	3.82	979
Gari	5.33	3.27		3732.63	8.6	0	0.47	2	0.3	2.77	3744
Kosovrasti i Epërm	9.42	5.08		734.4	14.5	0.5	0	2	0.6	3.1	752
Dibër	326.4	13.6		836.04	340	3.2	11.5	4.36	15.9	34.96	1211
Kosovrasti i Poshtëm	30.96	7.74		800.18	38.7	0.8	0.62	2.4	1.3	5.12	844
Krivcë	0	1.2		375.7	1.2	0	0	0	0.1	0.1	377
Mogorçë	35.75	29.25		1219.32	65	0.14	0.28	0.26	2	2.68	1287
Osoj	2.2	0.9		1077.2	3.1	0	0	1.5	0.2	1.7	1082
Otishan	13.68	12.62		821	26.3	0	0	0.6	1.1	1.7	849
Rajçicë	3.97	2.23		254	6.2	0	0.2	0.1	0.5	0.8	261
Sellokuq- Shullan	0.9	1.2		419.4	2.1	0	0	0	1.5	1.5	423
Spas	0	5.2		490.4	5.2	0	0	0	0.4	0.4	496
Tatar- Elevcë	0	1.1		442.7	1.1	0	0	0	0.2	0.2	444
Hame	2.81	2.39		314.5	5.2	0	0	0	0.3	0.3	320
Xhepishtë	13.06	6.44		321.15	19.5	0.12	0	0.13	1.1	1.35	342
Bomovë	0	0		516.29	0	0	0	0	0.71	0.71	517
Konjarë	0	0		646.15	0	0	0	0	0.85	0.85	647
Gjithsej:										14575	

Burimi: Kadastra dhe vlerësimi i komunës

Të dhënat e renditura në tabelën e mësipërme janë nxjerrë nga Kadastra e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe sipas vlerësimit të shërbimeve profesionale të komunës së Dibrës. Sipërfaqet e specifikuar në pikat 1.1; 1.2 dhe 1.3, të shprehura në hektarë, janë sipërfaqet e tokës ndërtimore, pa atarin e vendbanimit, ndërsa pika 1.4 tregon sipërfaqen e tokës së pa urbanizuar.

3.Trendet dhe projeksionet e popullatës

Tabela në vijim tregon numrin e popullsisë në komunën e Dibrës sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2002, si dhe projeksionin e popullsisë në 4 vitet e fundit, sipas Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tabela 8: Popullata në komunën e Dibrës ndër vite

Dibër	2002	2017	2018	2019	2020	2021
Gjithsejt:	19542	20939	21003	21044	21075	15412

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Numri i popullatës sipas banimit nëpër vendbanime, është dhënë në tabelën në vijim. Sqarim: Banim me shërbime është banimi ku popullata ka furnizim të plotë me rrjetin e ujësjellësit, rrjetin e kanalizimit, furnizimin me energji elektrike, internet dhe infrastrukturën e ndërtuar rrugore. Banimi me shërbime jo i mjaftueshëm është banim ku popullata nuk ka ofertë jo të plotë të shërbimeve të mësipërme, ndërsa banimi i parregullt është banim ku popullsia ka më pak se 10% të shërbimeve të mësipërme.

Tabela 9: Numri i populates sipas vendbanimeve nga vizita në teren

Vendbanim	Popullata			
	Popullata – Banim me shërbime	Popullata – Banim me shërbime jo i mjaftueshëm	Popullata – Banim i parregullt	Popullata gjithsejt
Banjisht	33	7		40
Gari	1	1		2
Kosovrasti i epërm	536	288		824
Dibër	14267	594		14861
Kosovrasti I poshtëm	936	234		1170
Mogorçë	1320	1080		2400
Otishan	435	402		837
Rajçicë	35	20		55
Hame	4	4		8
Xhepishtë	449	221		670
Gjithsejt:	18016	2851		20867

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe vlerësimet e komunës Dibër

Numri i popullsisë në tabelën e mësipërme është sipas vlerësimeve të komunës së Dibrës. Duke pasur parasysh se numri i popullsisë në komunën e Dibrës nga viti 2002 e deri më sot është në rritje të vazhdueshme, gjegjësisht është rritur për 1264 banorë ose 6%, por në një pjesë të madhe të këtyre vendbanimeve komuna po përballlet me emigrim të popullsisë në vendet e Evropës Perëndimore. Siç mund të konstatohet në analizën e numrit të banorëve paraqiten dallime, përkatësisht numri i banorëve në komunën e Dibrës në raport me numrin e banorëve nga regjistrimi i vitit 2021 (tabela numër 4.1) dhe numri i banorëve sipas vendbanimeve nga vizita në terren të marra nga bashkësitë lokale (Tabela nr. 9). Sa më sipër i referohet faktit se vizita në terren është realizuar gjatë muajit korrik, kur banorët që punojnë jashtë vendit kthehen në shtëpitë e tyre dhe nga ana tjetër, fakti që Regjistrimi u realizua në muajin shtator, periudhë kur banorët që punojnë përkohësisht jashtë vendit në masë të madhe largohen për punë të përkohshme jashtë vendit. Kjo dukuri e ndryshimit të numrit të banorëve është dinamike dhe ndihet në komunën e Dibrës, si dhe në komunat e tjera, ku emigrim i popullsisë në vendet e Evropës Perëndimore dhe në SHBA është mjaft i theksuar.

4. Ekonomia


Në komunën Dibër në vitin 2021 ka patur gjithsej 519 subjekte aktive afariste, nga të cilat 394 kanë keqë mikro, 117 të vogla, 7 ndërmarje të mesme dhe 1 ndërmarje e vogël. Numri i subjekteve aktive afariste nga viti 2017 deri më 2020, në globale është pothuajse i njejtë, me pak variabla, e cila mund të shihet në tabelën në vijim.

Tabela 10: Subjekte aktive afariste sipas madhësisë, sipas komunave, sipas viteve, gjendja 31 Dhjetor.

Dibër	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2018-2021
Gjithsej	500	507	517	519	+19
Mikro	398	396	396	394	- 4
Të vogla	98	105	115	117	+19
Të mesme	3	5	5	7	+4
Të mëdha	1	1	1	1	0

Burimi: Enti shtetëror për statistikë

Grafikoni nr. 1: Struktura e subjekteve aktive sipas sektorëve për vitin 2021.



Burimi: Llogaritje e autorit në bazë të të dhënave nga EShS

Nga grafikoni vërrehet që numri më i madh i subjekteve aktive, ndërmarjeve janë nga lëmia e Tregëtisë me sasi të mëdha dhe të vogla; ndreqje të makinave motorike dhe motoçikletave 38%, Të mesme, 11% janë nga lëmia e Objekteve për akomodim dhe veprimtari të shërbimeve me ushqim, 11% nga ndërmarjet janë nga lëmia e ndërtimtarisë, 10% nga lëmia e industrisë, 5% nga lëmia e transportit dhe magacinimit, ndërsa veprimtaritë e tjera ashtu siç janë të shkruara në grafikun.

Tabela 11: Numri i subjekteve aktive sipas numrit të të punësuarve, sipas rajoneve, sipas viteve, gjendja 3 Dhjetor.

Rajoni Jugperëndimor	2018	2019	2020	2021
Gjithsej	7209	7520	7268	7218
0 të punësuar ose ska të dhëna	675	558	397	393
1 - 9	6010	6423	6346	6290
10 - 49	405	420	399	412
50 - 249	107	108	115	111
250+	12	11	11	12

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Nga tabela më sipër e cila i rreferohet rajonit Jugperëndimor, duke patur parasydh që Enti shtetëror i statistikave nuk ka të dhëna të tilla të selektuara sipas komunave, shikojmë që numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve në këtë rajon është në rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2019, rënie më të madhe ka në ndërmarjet me 0 të punësuar ose që kanë të dhëna, ka rritje të ulët të ndërmarjeve të cilat kanë nga 1- 10 të punësuar.

Në tabeleën në vijim, mund ti shikojmë numrin e ndërmarjeve sipas sektorëve të veprimtarisë.

Tabela 12: Subjekte afariste aktive sipas sektorëve të veprimtarisë sipas KNV Rev. 2, sipas komunave, sipas viteve, gjendja 31 Dhjetor.

	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2018-2021
Gjithsej	500	507	517	519	+19
A Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	10	10	11	0
B Minerale dhe nxjerje e gurrëve	-	-	1	1	+1
V Industri përpunuese	50	54	50	50	0
G Furnizim me energji elektrike, gas, avull dhe klimatizim	-	-	-	-	0
D Furnizimi me ujë; mënjanim i ujërave të mbetjeve; menaxhim me mbetjet; riparim i rrethinës	1	1	1	1	0
Gj Ndërtimtari	43	44	54	59	16
E Tregëtim me të madhe dhe të vogël; ndreqje e makinave motorike dhe motoçikletave	202	201	202	195	-7
Zh Transport dhe magazinim	24	24	26	26	+2
Z Objekte për akomodim dhe veprimtari shërbyese me ushqim	61	56	57	56	-5
X Informacione dhe komunikim	3	3	3	2	-1
I Veprimtari financiare dhe veprimtari me sigurime	4	4	4	4	0
J Veprimtari në lidhje me pronën e patundshme	-	-	1	1	+1
K Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	22	24	27	29	+7
L Veprimtari administrative dhe shërbyese ndihmëtare	9	10	9	8	-1
Lj Drejtori publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm	3	3	3	3	0
M Arsim	5	5	6	6	+1
N Veprimtari të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	35	36	35	34	+1
Nj Art, zbavitje dhe rekreim	11	11	10	11	0
O Veprimtari të tjera shërbyese	16	21	18	22	+6

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Sipas tabelës, numri më i madh i subjekteve afariste në teritorin e komunës Dibër janë nga lëmia e Tregëtisë me të madhe dhe të vogël; ndreqje të makinave motorike dhe motoçikletave. Numri i këtyre subjekteve afariste nuk ka variuar shumë në 4 vjet e fundit, është zvogëluar për vetëm 7 ndërmarje. Rritje vërehet tek subjektet afariste nga ndërtimtaria për 16 ndërsa numri i subjekteve afariste në të gjitha lëmitë thujase nuk ka ndryshuar, varion për ± 7 ndërmarje.

Tablea 13: Subjekte afariste një pronësi private të rregjistruara në komunën e Dibrës me më tepër se 10 të punësuar, sipas veprimterive dhe numrit të të punësuarve për vitin 2021.

Veprimtaria	Emërtim i subjektit	Vendi	Numri i të punësuarve
Industri përpunuese	ShA Knauf- Dibër	Dibër	145
Transport dhe magazinim	Flamuri	Dibër	11
Industri përpunuese	Digips	Kosovrast i Poshtëm	21
Ndustri për përpunimin e metalit	Diekotec	Dibër	25
Akomodim dhe shëndetësi	Banjat e Dibrës-Capa	Dibër	180
Industri përpunuese- furrë	Elita	Dibër	24
Tregëti dhe shërbime	Prima Petrol	Dibër	11
Veprimtari shërbyese- “kall qendër”	Slice	Dibër	220
Veprimtari shërbyese- “kall qendër”	Enzo Aero	Dibër	11
Veprimtari shërbyese- “kall qendër”	Fiks- repond	Dibër	22
Tregëti dhe shërbime	Dashi Komerc	Dibër	31
Tregëti dhe shërbime	Mega Market	Dibër	26
Tregëti dhe shërbime	Amir Market	Dibër	16
Prodhim të energjisë elektrike	CHE Shpile	Dibër	80

Burimi: Komuna Dibër

Përkrah subjekteve private afariste të përmendura të cilat janë në territorin e komunës Dibër, për zhvillimin e ekonomisë të komunës me rrëndësi të veçantë janë remitancat nga mërgimtarët me punësim të përkohshëm në shtetet e jashtme.

4.1 infrastruktura rrugore lokale dhe banimi

Infrastruktura rrugore lokale në komunën Dibër, si një nga kushtet themelore për zhvillimin e vetë komunës, është në përmirësim të vazhdueshëm në vitet e fundit, dhe do të vazhdojë të përmirësohet edhe në të ardhmen. Në vitin 2015 me asfalt dhe pllaka janë mbuluar 86 km rrugë lokale, përderisa në vitin 2020 me asfalt dhe pllaka janë mbuluar 107km të rrugëve lokale, e cila paraqet rritje për 21km. Të dhënat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 14: Rrjeti rrugor loka, sipas komunave, sipas viteve.

Dibër						
	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej	163	210	210	210	210	210
Asfalt dhe pllaka	86	107	107	107	107	107
Makadam	36	47	47	47	47	47
Tokë në dhe	35	42	42	42	42	42
Të pashtypura	6	14	14	14	14	14

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Tabela 15: Lloji i vendbanimit, numri dhe sipërfaqja e banesave, numri i banimeve individuale, dhe sipërfaqja mesatare për banor të banimit individual.

Komuna	Numri përgjithshëm i vendbanimeve	Numri përgjithshëm i vendbanimeve	Sipërfaqja e përgjithshme e dyshemesë në m ²	Sipërfaqja e dyshemesë të vendbanimeve të përfshira nga banimet individuale	Numri i banimeve individuale në vendbanime	Numri i anëtarëve në banime individuale	Sipërfaqja mesatare e dyshemesë (të vendbanimeve të përfshira nga banimi individual) nga anëtarët e banimit	Vendbani met e mbetura
Dibër	4606	4602	463701	396710	3913	19535	20.3	4

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

4.2 Bujqësia

Të ardhurat dhe gjendja e mirë e numrit më të madh të popullsisë së komunës Dibër drejtpërdrejtë varren nga sektori i bujqësisë. Në rregjistrin amë të ndërmarjeve bujqësore ka 1365 persona aktivë.

Numrat zyrtare tregojnë që bujqësia mundëson punësimin e 36% të numrit të përgjithshëm të të aftëve ër punë në shtet. Por përsëri, numri real është shumë më i lartë sepse shpesh aktivitetet bujqësore zhvillohen në ferma të vogla familiae, ndërsa lloji kryesor i punësimeve në këta familje bujqësore është punësimi familjar joformal.

Sipërfaqja e përgjithshme bujqësore në komunën Dibër është 10870 hektarë, nga të cilat 2454 hektarë janë tokë punuese, 1872 hektarë janë toka të lëvrueshme dhe kopshte, 120 hektarë janë pentari, 2 hektarë vreshta, 460 hektarë livadhe dhe 8415 hektarë kullosa. Duke parë karakterin bujqësor të komunës Dibër, përkrah kapaciteteve të lartpërmendura gjithashtu egziston potenciali për hapjen e objekteve afariste për përpunimin e frutave, zarzavateve, qumështit dhe prodhimeve qumështore, prodhimeve të mishit dhe prodhimeve të ushqimit për kafshët.

Tabela 16: Sipërfaqjet bujqësore sipas kategorive të shfrytëzimit sipas komunave sipas NNjTS 2013

Komuna Dibër	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Sipërfaqje bujqësore	8859	8845	10876	10870	10870	10870
Sipërfaqja e përgjithshme punuese	2458	2444	2450	2444	2444	2454
Toka të lëvrueshme dhe kopshte	1891	1872	1878	1872	1872	1872
Pentari	115	120	120	120	120	120
Vreshta	2	2	2	2	2	2
Livadhe	450	450	450	450	450	460
Kullosa	6400	6400	8425	8425	8425	8415

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Sipas tabelës më sipër, numri më i madh i sipërfaqjeve punuese shfrytëzohen për toka të lëvrueshme dhe kopshte, ndërsa më pak për vreshta.

Tabela 17: Sipërfaqje dhe prodhime bimore sipas komunave, sipas NNjTS 2013

Komuna Dibër	Sipërfaqja e mbjellë në hektarë					
	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Grurë	350	360	360	360	350	355
Thekër	20	20	20	20	15	18
Elb	20	15	15	15	15	18
Tërshërë	10	20	20	20	20	20
Misër	150	160	160	160	150	155
Duhan	15	15	15	15	10	12
Patate	40	40	46	40	30	42
Qepë	15	10	10	10	10	10
Hudhër	1	1	1	1	1	1
Fasule- kultura kryesore	5	5	5	5	5	6
Bizele- kokërr	4	5	5	5	5	6
Lakër	10	10	10	10	10	10
Domate	10	10	10	10	10	10
Specë	10	10	10	10	10	10
Kastraveca	1	1	1	1	1	1
Tërfill	60	60	60	60	60	70
Jonxhë	950	900	900	900	900	900
Misër foragjer	10	15	15	15	15	16
Rrepë foragjere	5	5	5	5	5	6

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Kulturat të cilat janë më të përfaqësuara sipas të dhënave në tabelë janë jonxha deri sa kulturat më popullore janë gruri, misri, patatja, speci, domatja dhe lakra. Gjithashtu, nga tabela vërrehet që asnjë nga të mbjellat nuk është rritur në mënyrë drastike në vitet e fundit. Disa nga kulturat kultivohen në sasi të njejta ose të ngjajshme.

Tabela 18: Numri i kërcellve frutorë dhe prodhimit të frutave sipas komunave, sipas NNjTS 2013

Dibër							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Qersh	2500	2500	2500	2500	2500	2500	2550
Vishnje	850	850	850	850	850	850	900
Kajsi	550	550	550	550	550	550	600
Ftonj	1900	1900	1900	1900	1900	1900	1900
Molla	10000	10000	10000	10000	10000	10000	10000
Dardha	8000	8000	8000	8000	8000	8000	8050
Kumbulla	8000	8000	8000	8000	8000	8000	8050
Pjeshka	900	900	900	900	900	900	950
Arra	5400	5400	5400	5400	5400	5400	5450

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

4.3 Turizmi dhe hotelieria

Në lëminë e turizmit në nivel komunal është zhvilluar turizmi i llixhave ku bartës i saj është rezorti shëndetësor “Banjat e Dibrës- CAPA” me mbi 150 të punësuar dhe kapacitet akomodues prej 700 shtretërisht në Hotel Banjisht në fshatin Banjisht, Hotel Termal në fshatin Kosovrast i Poshtëm dhe Hotel Venec në Dibër. Përveç turizmit të llixhave mund të zhvillohet edhe turizmi liqenor, malor dhe rural. Turizmi dhe hotelieria paraqesin dego të rëndësishme të zhvillimit ekonomik lokal duke patur parasysh atraksionet natyrore, ujërat termomineral, mallet, hidrografinë e pasur të lumejve dhe Liqenit të Dibrës, trashëgiminë kulturore dhe potencialet e tjera për zhvillimin e turizmit të kombinuar. Vizitorët që vizitojnë Dibrën janë turistë vendas ndërsa kohët e fundit çdo ditë e më shumë edhe të huaj. Përveç komplekseve banjore, kapacitete akomoduese ofrojnë dhe objektet e tjera më të vogla dhe shtëpitë nëpër fshatra.

Tabela 19: Kapacitete akomoduese dhe kapacitete hotelierike

Kapacitetet akomoduese, sipas komunave, sipas Regjistrimit në hotelieri, 2008				
	Numri i objekteve hotelierike	Numri i shtretërve	Sipërfaqja e objekteve (m ²)	Numri i të punësuarve
Dibër	5	542	1180	90

Kapacitetet akomoduese, sipas komunave, sipas Regjistrimit në hotelieri, 2008			
	Numri i objekteve hotelierike	Sipërfaqja e objekteve (m ²)	Numri i të punësuarve
Dibër	52	3359	128

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Tabela 20: Numri dhe bujtjet të turistëve vendor dhe të huaj

Numri dhe bujtjet e turistëve vendas dhe të huaj sipas vendit të origjinës, 2016-2021				
	viti	Turistë vendas	Turistë të huaj	Gjithsej
Numri I turistëve	2016	6673	3528	10201
	2017	9312	3590	12902
	2018	8502	4928	13430
	2019	9009	4672	13681
	2020	4635	726	5361
	2021	7052	2127	9179
Numri I bujtjeve	2016	49174	23242	72416
	2017	61466	23034	84500
	2018	61040	28111	89151
	2019	58702	27722	86424
	2020	22494	3828	26322
	2021	33232	12134	45366

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Nga kjo tabelë vërehet që në periudhën 2016- 2019 ka rritje në numrin e turistëve dhe numrin e bujtjeve. Gjithashtu vërehet që ka rritje të vazhdueshme edhe në numrin e turistëve të huaj.

Në periudhën 2020- 2021 vërehet që ka rënie drastike të numrin të turistëve e cila është si pasojë e masave për izolim për shkak të pandemisë so COVID- 19, në të cilën periudhë kapacitetet akomoduese ishin mbyllur ose punonin me kapacitet të kufizuar.

5. Shërbime, mjete dhe mirëmbajtje

Komuna Dibër gjeografikisht është e ndarë në dy pjesë, dhe atë në pjesën e rrafshët e cila perfshin territorin e Fushës së Dibrës, dhe në pjesën kodrinoro- malore.

Në pjesën e rrafshët ndodhen vendbanimet në vijim: Dibra, Bomova, Konjara, Krivca, Sellokuqi, Spasi, Taraniku dhe Hamja.

Në pjesën kodrinoro- malore ndodhen vendbanimet në vijim: Banjishti, Gari, Kosovrasti i Poshtëm, Kosovrasti i Epërm, Mogorça, Osoi, Otishani, Rajçica, Tatar Elevca dhe Xhepishta.

Në pjesën e rrafshët të komunës, pjesa më e madhe e vendbanimeve nuk janë të përfshira me shërbimet komunale, për arsye se përveç qytetit të Dibrës, të gjitha vendbanimet e tjera janë të emigruar. Në lidhje me infrastrukturën rrugore, rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimit me energji elektrike, Dibra është në gjendje të qëndrueshme përderisa vendbanimet e tjera kanë disa mangësi në lidhje me kycjen në infrastrukturë. Të gjitha vendbanimet, përveç taranikut, kanë sistem të ujësjellësit, furnizim me energji elektrike. Me infrastrukturë rrugore, vendbanimet Krivcë, Sellokuq, Spas dhe Hame kanë dalje në rrugën rajonale Dibër- kalimi kufitar Bllatë (Republika e Shqipërisë). Rrjet të kanalizimit ka vetëm në vendbanimet Dibër- Hame. Shërbime komunale- mbëledhje të

mbetjeve ka vetëm në qytetin e Dibrës. Në lidhje me kyçjen deri te objektet e suprastrukturës, shkollë fillore ka vetëm në Dibër, të cilat shërbejnë edhe për nxënësit e vendbanimeve të tjera, dhe në të cilat duhet të intervenohet në pjesën e efikasitetit energjetike. Kopsht për fëmijë ka vetëm në Dibër. Sallë sportive ka në Dibër dhe në shkollat fillore në Dibër. Në lidhje me objektet e shëndetësisë, në Dibër ndodhet Shtëpia e Shëndetit e cila shërben si spital për Komunën Dibër dhe Komunën Qendër Zhupë, ndërsa në vendbanimet e tjera kanë qasje deri te mjeku amë. Nga aspekti i kulturës dhe rekreimin, në Dibër ndodhet Institucioni publik- Qendra për kulturë- Dibër. Nga aspekti i administratës publike, selia e Njësisë së vetëqeverisjes lokale së Komunës Dibër ndodhet në Dibër, njëkohësisht në Dibër ndodhet edhe selia e NKP Standard- Dibër, Njësia e zjarrfikësive e cila i përfshin komunat Dibër, Qendër Zhupë dhe Mavrovë dhe Rostushë, dhe njësitë rajonale të Ministrisë së financave, Ministrisë së drejtësisë, Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Ministrisë së shëndetësisë, Ministrisë së punëve të brendëshme, Ministrisë së mbrojtjes, Qendrës rajonale për menazhim me kriza, Inspektoratit shtetëror të tregut, Inspektoratit shtetëror të bujqësisë, Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, Drejtorisë për mbrojtje dhe shpërim, Gjykatës themelore, Postës së Maqedonisë, Thesarit të RMV- së, Qendrës ndërkomunale për punë sociale, Shtëpisë së pensionistëve- Dibër, Agjencisë për kadastrë të patundshmërive, Agjencisë për ushqim dhe veterinari, Agjencisë për punësim, Stacionit të policisë- Dibër, Drejtorisë së doganave- Kalimit kufitar Bllatë. Në të gjitha vendbanimet në pjesën e rrafshët ka rrënie të numrit të popullsisë.

Përndryshe, vendbanimet kodrinoro- malore, kanë infrastrukturë rrugore të mirë, të gjitha janë të furnizuara me energji elektrike dhe kanë rrjet lokal të ujësjellësit. Shërbime komunale për pastëri publike ende nuk ka në këta vendbanime. Rrjetë të kanalizimit ka në të gjitha këta vendbanime përveç se në fshatin Gari, Osoj, dhe Tatar Elevcë. Në lidhje me objektet e suprastrukturës, shkollë fillore ka në fshatrat Mogorçë, Kosovrast të Poshtëm dhe Kosovrast të Epërm derisa shkollë të mesme ka në fshatin Mogorçë. Ka nevojë për vënie në rifunksionim të kopshtit për fëmijë në fshatin Mogorçë sipas numrit të popullsisë si fshati më i madh në Komunën Dibër. Shërbime komunale- mbëledhje të mbetjeve nuk ka në asnjë vendbanim, përveç se në fshatin Rajçicë, për arsye se ky është fshati më i afërt me Dibrën. Në këta vendbanime nuk ka objekte të kulturës. Në lidhje me objektet e shëndetësisë, ambulanta të vogla ka në fshatrat Kosovrast i Poshtëm, Kosovrast i Epërm, Xhepishhtë- Otishan dhe Mogorçë, përderisa banorët në vendbanimet e tjera kanë qasje në shërbimet shëndetësore nëpërmjet mjekut amë. Në aspektin e administratës publike, në fshatin Xhepishhtë gjindet zyra rajonale e Drejtorisë për udhëheqjen e librave amë, Stacioni i policisë- Xhepishhtë dhe Drejtoria e doganave- Kalimi kufitar Xhepishhtë. Popullsia në këta vendbanime është në rënie të vazhdueshme.

Në tabelën Lista e infrastrukturës dhe programimit të shërbimeve (LIPSh), në pjesën rezultate është gjendja e rradhës:

- Dendësia dhe banimi në komunën Dibër është me vlerësim mesatar 24,94, që është edhe gjendja reale.
- Gjendja me rrugët në komunë, vlerësimi mesatar sipas tabelës LIPSh është 16840,10. Pjesa më e madhe e drejtimeve rrugore në vendbanime janë të asfaltuara, përveç se në disa lagje në fshatra ku do të duhet të rikonstruohen- asfaltohen një pjesë e rrugëve, si përshembull në lagjen Drugo maalo në Mogorçë, trotuarin në lagjen Dollno maallo në Xhepishhtë, rrugës lokale deri te Sredno maallo në Rajçicë etj. Gjithashtu, në Dibër ka nevojë për rikonstruimin e rrugëve egzistuese dhe

ndërtimit të të rrejave në bazë të kërkesave.

- Në pjesën e shërbimeve ekologjike dhe sanitare, Gari nuk ka rrjet të kanalizimit, të vendosen shërbimi për pastërtinë publike- mbëledhje të mbetjeve komunale për të gjitha vendbanimet jashtë qytetit të Dibrës, të gjitha vendbanimet janë të mbuluara me energji elektrike dhe kanë rrjetë të ujësjellësit nga ujësjellësit lokalë.
- Rrjeti i ujësjellësit- është e nevojshme të rikonstuoet dhe më mirë të menaxhohet me vendbanimet Dibër, Mogorçë, ndërmim të ventilëve dhe kaptazhave në Mogorçë dhe Xhepishtë, betonim të kanalit për vaditje në Xhepishtë, rikonstruim të rezervarit në Gorno maallo në Otishan, rrjetit të kanalizimit për kullimin e ujrërave atmosferikë në Kosovrast të Epërm, sanim të rrjetit të ujësjellësit në Kosovrast të Poshtëm dhe ndërtimit të rezervarit të rri të ujit, përderisa në vendbanimet e tjera ka rrjetë të ujësjellësit.
- Qasja në objektet suprastruturore- në Dibër funksionon kopshi për fëmijë, shkolla fillore ka në Dibër, Kosovrast të Poshtëm, Kosovrast të Epërm, Mogorçë dhe Xhepishtë. Në Dibër dhe Mogorçë funksionojnë edhe shkollat e mesme, ku në Dibër objekti është i ri i ndërtuar ndërsa në Mogorçë është në gjendje solide. Në vendbanimet e përmendura ka kushte optimale për mësim. Është e nevojshme të intervenohet në shkollat në Dibër- ShFK Penestia, Mogorçë- shkollën fillore, Mogorçë- shkollën e mesme, Xhepishtë- shkollën fillore, Kosovrast i Poshtëm- shkollën fillore, ndërtesën e komunës Dibër, objektin e NKP Standard- Dibër, dhe rikonstruimin e Kopshtit për fëmijë Breshia, në pjesën e efikasitetit energjetik me qëllim përmirësimin e kushteve dhe kursimin e energjisë.
- Është e nevojshme vënia në funksion e kopshtit për fëmijë në fshatin Mogorçë duke patur parasysh numrin e popullsisë, gjegjësisht ky fshat është më i madhi në komunën Dibër dhe për arsye se objekti egziston dhe mëparë ka kryer funksionin si kopsht për fëmijë.
- Me qëllim zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rinore, kërkesat e banorëve janë që të ndërtohen terene multifunkionale dhe rikonstruimin e tereneve të hapura nëpër të gjitha vendbanimet. Është i nevojshëm ndriçimi i terrenit sportiv në Kosovrast të Epërm. Salla sporti ka vetëm në Dibër.
- Gjithashtu, në pjesën e kulturës dhe rekreimit, përveç se në Dibër, në vendbanimet e tjera mungojnë objektet e kulturës, të mbështeten aktivitete të llojllojshme rekreative dhe kulturore me qëllim të pasurimit të aktiviteteve kulturore dhe tradicionale. Në Dibër është i nevojshëm rikonstruimi i sallës së shfaqeve në Qendrën për kulturë dhe hapja e Muzeut të Rajonit të Dibrës.
- Në të gjitha vendbanimet e komunës Dibër ka nevojë për mirëmbajtje dhe vendosje të ndriçimit publik.

Rezultatet përfundimtare në bazë të Listës së infrastrukturës dhe programimit të shërbimeve janë dhënë në tabelën në vijim nga ku mund të vërrehet ndryshim i madh ndërmjet vendbanimeve rafshinore nga ato kodrinoro- malore në pikëpamje të numrit të popullsisë, qasjes në objektet suprastruturore dhe shërbimeve ekologjike sanitare. Ngabtabel dhe rezultatet përfundimtare vërrehet që në të gjitha vendbanimet fshatare ka nevojë për menaxhim më të mirë me mbetjet, këta vendbanime mbetjet e tyre i hudhin në deponi të egra për arsye se ndërmarrja komunale publike nuk ka mundësi për dhënien e këtij shërbimi për shkak të pajisjes së pamjaftueshme në dispozicion, gjegjësisht mungesa e automobilit special për mbëledhjen e mbetjeve. Megjithatë, komuna mundohet ta gjallërojë këtë rajon, me projekte në numërta dhe përpjekje që të zhvillohet turizmi rural, për të cilën komuna Dibër ka kapacitet solid.

